



Republika e Kosoves
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovo Standardisation Agency
Kosovska Agencija za Standardizaciju

DATE/A:	11.11.2025
REFERENC-E:	
PER/ZA/TO:	Mentor Arifaj, Zëvendësminister në MINT
CC:	Agim Xhuraj, Ud. Sekretar i Përgjithshëm në MINT Kushtrim Dakaj, Shef i Kabinetit të MINT
PERMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Mehdi Pllashniku, Drejtor i Drejtoratit për Standarde, Promovim dhe Integrim në AKS
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Performancës për Agjencinë Kosovare të Standardizimit AKS-2026

I nderuar zv.Minister,

Referuar nenit 30 të Ligjit m. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, neni 7 i Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore, dhe duke u bazuar në kompetencat e veta ligjore, Agjencia Kosovare e Standardizimit ka hartuar Planin e Performancës për vitin 2026.

Bashkëlidhur gjeni:

- Planin e Performancës për Agjencinë Kosovare të Standardizimit.

Sinqerisht,
AKS



Republika e Kosoves
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveri(l-V)/(Id(l-Government

Ministria e Industrise, Ndermarresise dhe Tregtise
Ministarstvo Industrije, Preduzetnistva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovo Standardisation Agency
Kosovska Agencija za Standardizaciju

PLANI I PERFORMANËS

AGJENCIA KOSOVARE E STANDARDIZIMIT

2026

Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), është i vetmi organ i administratës shtetërore për standardizim në Republikën e Kosovës, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. AKS siguron platformën për zhvillimin e standardizimit, duke mbështetur cilësinë dhe sigurinë e produkteve, proceseve dhe shërbimeve si dhe përhapjen e njohurive përmes standardeve, të cilat në mënyrë të vazhdueshme i zhvillon/adopton/miraton duke i dhënë prioritet atyre që kërkohen nga palët e interesit, ato që kanë më shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit dhe standardet të cilat janë referencë në direktivat evropiane ose rregullore të transpozuar në legjislacionin vendor.

Standardizimi, është aktivitet i përcaktimit të rregullave për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, për probleme aktuale apo të tjera që mund të krijohen, që ka për qëllim arritjen e një shkalle optimale të rregullit në një kontekst të caktuar. Standardizimi realizohet me konsensus nga dhe për vetë palët e interesit, bazuar në gjithë përfshirje dhe transparencë.

Standardi, është dokument i hartuar me konsensus dhe i aprovuar nga një organ i njohur standardizimit, i cili ofron, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime apo karakteristika për aktivitetet apo rezultatet e tyre, që kanë për qëllim arritjen e një shkalle optimale rregulli në një kontekst të dhënë me të cilën pajtueshmëria është vullnetare.

Agjencia Kosovare e Standardizimit, është përgjegjëse për:

- miratimin dhe mirëmbajtjen e standardeve kosovare dhe përditësimin e katalogut të standardeve;
- shqyrtimin, mirëmbajtjen dhe konfirmimin periodik të statusit të standardeve kosovare në përputhje me rregullat dhe procedurat e standardizimit të miratuara nga AKS;
- zhvillimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave mbi aktivitetet e standardizimit, në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- përgatitjen, miratimin dhe publikimin e programit të punës për standardizim në përputhje me interesin e palëve;
- hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin, ndryshimin, shfuqizimin dhe publikimin e standardeve kosovare dhe dokumenteve kosovare të standardizimit në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të standardeve;
- administrimin dhe mirëmbajtjen e arkivit për standardet kosovare, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe shitjen e tyre në përputhje me ligjet, rregullat dhe politikat e zbatueshme të marrëveshjeve me organet e standardizimit;
- ofrimin e shërbimeve të informimit për standardet dhe procedurat e standardizimit për subjektet afariste që kryejnë aktivitet ekonomik brenda dhe jashtë vendit;
- të vepruar si pikë referimi për çështjet e ndërlidhura me standardizimin që rezultojnë nga marrëveshjet me organizatat evropiane dhe ndërkombëtare në lidhje me barrierat teknike në tregti dhe kodin e praktikës së mirë për hartimin, miratimin dhe publikimin e standardeve;

- € shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin në fushën e standardizimit me organet e huaja nacionale të standardizimit;
- € organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera të ndërlidhura me standardizimin;
- € publikimin e buletinit dhe katalogut vjetor me standardet kosovare; dhe
- € iniciimin e studimeve, publikimeve, përvojës, punës kërkimore dhe aktivitete të tjera që kanë lidhje me standardizimin.

AKS, si organ i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit: CEN; CENELEC; ETSI dhe ISO; IEC; ITU, si dhe në organizatat tjera që kanë të bëjnë me standardet. Gjithashtu, është autoritet shtetëror i Notifikimit dhe Pikë e Referimit në OBT për standarde.

Korniza ligjore e AKS:

- € Ligji nr. 06/L-019 për standardizim;
- € Strategjia Afatmesme e Agjencisë Kosovare për Standardizim (2020-2025);
- € Udhëzimi Administrativ nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit;
- € Udhëzimi Administrativ nr. 10/2018 për Logon e AKS;
- € Udhëzimi Administrativ nr. 16/2018 për Komitete Teknike;
- € Rregullore (QRK) nr. 28/2018 për mënyrën e notifikimit dhe ofrimit të informacioneve mbi rregulloret teknike, procedurat për vlerësimin e konformitetit dhe standardet;
- € Rregullore e Brendshme nr. 01/2019 për standardet e harmonizuara kosovare;
- € Rregullore e Brendshme nr. 02/2020 për rregullat dhe procedurat për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane si standarde kosovare;
- € Rregullore e Brendshme nr. 03/2022 për notifikimin e standardeve në CEN/CENELEC;
- € Marrëveshja Licencë ndërmjet AKS dhe CEN/CENELEC.

Hyrje

Agjencia Kosovare e Standardizimit, ka hartuar Planin e Përformancës, duke u bazuar në nenin 30 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, dhe nenin 7 të Rregullorës (QRK) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të përformancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore.

Përmes këtij plani të përformancës, AKS paraqet vizionin si një institucion i fuqishëm shtetëror për standarde, i njohur nga ata që zbatojnë standarde dhe nga të gjitha palët e interesit në nivel vendi, si dhe një bashkëpunëtorë shumë i mirë dhe i besueshëm në nivelin rajonal, evropian dhe ndërkombëtar.

Plani i Përformancës së AKS, lidhet edhe me objektivat e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, dhe në bazë të kësaj janë planifikuar pesë objektiva të domosdoshme për AKS.

Përmbledhje e objektivave

Objektivat e Planit të Përformancës së AKS janë:

- 1. Zhvillimi, adoptimi dhe miratimi i standardeve**
- 2. Këshilli Profesional i Standardizimit dhe Komitetet Teknike**
- 3. Promovimi i standardizimit, rolit dhe rëndësisë së standardeve**
- 4. Menaxhimi dhe funksionalizimi i data bazës SMIS dhe WEB**
- 5. Notifikimi i standardeve në CEN; CENELEC; DPS dhe ASTM**

1. Zhvillimi, adoptimi dhe miratimi i standardeve

Bazuar në Ligjin nr. 06/L-019 për standardizim, AKS gjatë vitit 2025 do të vazhdon me zhvillimin, adoptimin dhe miratimin e standardeve për të gjithë sektorët e ekonomisë, industrisë dhe gjithashtu për plotësim të legjislacionit me theks të veçantë për rregulloret teknike të cilat i referohen standardeve. Për të siguruar që standardet janë në fuqi, AKS në vazhdimësi do të rishikon standardet e miratuara në një periudhë nga një deri në pesë vjet (standardet mund të rishikohen edhe me shpejt nëse ka kërkesë nga palët e interesit, me informacionin për shfuqizim të marrë nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, me ndryshimin e teknologjisë ose ndryshime tjera eventuale).

2. Këshilli Profesional i Standardizimit dhe Komitetet Teknike

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit, AKS

do të mbanë dy takime të rregullta të Këshillit gjatë vitit 2026, me qëllim të miratimit të programit të punës dhe rekomandimit të aktiviteteve lidhur me fushën e standardizimit. Ndërsa referuar Udhëzimit Administrativ nr. 16/2018 për Komitete Teknike, AKS planifikon të zhvillojë rreth 560 standarde të cilat janë me prioritet për sektorët e ndërtimit, derivateve të naftës dhe gazit; sistemeve të menaxhimit të cilësisë; transportit dhe shërbimeve postare; elektroteknikës; metrologjisë; shëndetësisë; energjisë; përpunimit të drurit; makinerisë; lodrave pajisjeve sportive dhe rekreacionit; teknologjisë agroushqimore; minierave dhe mineraleve; tekstilit dhe lëkurë këpucëve; mjedisit; pajisjeve mbrojtëse personale; metaleve, plastikës dhe elektrikës; teknologjisë informative; euro kodeve; dhe turizmit.

3. Promovimi i standardizimit, rolit dhe rëndësisë së standardeve

Promovimi dhe publikimi i secilit standard kosovar, pastaj promovimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të AKS dhe rolit e rëndësisë së standardeve dhe standardizimit do të jetë prioritet i Agjencisë për vitin 2026. Gjithashtu planifikojmë që gjatë këtij viti të identifikojmë aktet ligjore të ministrive të linjës me qëllim që rregulloret teknike që transpozohen nga direktivat e Bashkimit Evropian t'i referohen në mënyrë të saktë standardeve të harmonizuara.

Me qëllim të realizimit sa më efektiv të promovimit, do të zhvillohen aktivitetet si më poshtë:

- € 12 sesione informuese;
- € 2 buletine të standardeve;
- € Katalogu i standardeve;
- € Materiale të ndryshme promovuese;
- € Informacion dhe konsulencë për standarde.

4. Menaxhimi dhe funksionalizimi i data bazës SMIS dhe WEB

Data baza e Standardeve SMIS (Standards Management Information Systems), është sistem i domosdoshëm për funksionimin dhe modernizimin e Agjencisë Kosovare të Standardizimit, e cila siguron porosi online për shitjen e standardeve, rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj bizneseve dhe çdo palë tjetër të interesuar për standarde. Gjatë vitit 2026, planifikojmë identifikimin dhe sistemimin e të gjitha standardeve të reja për adoptim dhe ato për shfuqizim, të cilat pastaj përmes lidhjes me ueb faqe i ofrojmë çdokujt që është i interesuar, informacion të plotë për standarde dhe standardizim.

5. Notifikimi i standardeve në CEN; CENELEC; DPS dhe ASTM

Të gjitha standardet e adoptuara dhe të shitura jemi të obliguar t'i notifikojmë në organizatat e standardizimit CEN; CENELEC; ASTM dhe DPS. Në këtë kuptim, AKS planifikon të notifikon rreth 550 standarde të reja për adoptim dhe rreth 200 standarde të shitura për vitin 2026.

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2026; në kategoritë e pagave, shtesave dhe kompensimeve, si dhe mallra dhe shërbime janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

KATEGORIA	BUXHETI 2026
Pagat, shtesat dhe kompensimet	88,803.72
Shërbimet kontraktuese tjera	15,800.00
Blerja e mobileve dhe pajisjeve (me pak se 1000euro)	2,000.00
Shpenzimet e marketingut	6,700.00
Shpenzimet e përfaqësimit	6,233.00
Shpenzimet e udhëtimit	17,000.00
Totali i aprovuar për 2026	136,536.72€

Tabela e planit të punës

Data:	11.11.2026						
AGJENCIA	Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS)						
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë						
Misioni i Agjencisë	Zhvillimi, adoptimi dhe miratimi i standardeve, sipas politikave dhe rregullave evropiane dhe ndërkombëtare për të stimuluar fuqishëm zhvillimin ekonomik, për të mbrojtur shëndetin, për të përmirësuar sigurinë dhe për të rritur cilësinë, për të krijuar bazën për konkurrencë në rajon dhe më gjerë, duke synuar drejt një të ardhme të qëndrueshme.						
Objektivat	Treguesi (t)	Vlera bazë	Vlera e synuar	Outpute	Aktivitetet kryesore	Aloki mi financiar	Referenca në dokumente strategjike/politike
I. Zhvillimi, adoptimi dhe miratimi i Standardeve	Rreth 560 standarde të reja të adoptuara dhe rreth 450 standarde të shfuqizuara	13970 SK të Miratuara dhe 5835 SK të Shfuqizuara	Rreth 14530 SK të miratuar dhe 6285 SK të shfuqizuara	SK të miratuar a për të gjitha palët e interesit	Miratimi i Standardeve Kosovare SK	12,000.00 €	Ligji nr. 06- L-019 për standardizim; Strategjia Afatmesme e Agjencisë Kosovare për Standardizim m 2020 - 2025.
2. Këshilli Profesional i Standardizimit dhe Komitetet Teknike	Këshilli Profesional i Standardizimit dhe Komitetet Teknike aktive	KT. për Ndërtim; Derivate të Naftës dhe Gazit; Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë; Transport dhe Shërbime Postare; Elektroteknikë; Metrologji; Shëndetësi;	Dy takime të KPS; Rreth 20 takime të KT	SK të jenë në përputhje me hmeri të plotë me standardet EN dhe ISO/IEC	Aprovimi i Programit 6 mujor të punës; Zhvillimi i standardeve nëpërmjet Komiteteve Teknike	6,233.00 €	UA nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit; UA nr. 16/2018 për Komitete Teknike; Strategjia Afatmesme e Agjencisë Kosovare

		Energji; Përpunim i Drurit; Makineri; Lodra, Pajisje Sportive dhe Rekreacion; Teknologji Agroushqim ore; Miniera Minerale; Tekstil dhe Lëkurë Këpucë; Mjedis; Pajisje Mbrojtëse Personale; Metale, Plastike dhe Elektrike; Teknologji Informative; Eurokode; Turizëm.					për Standardizi m 2020 - 2025.
3. Promovimi i standardizimit, rolit dhe rëndësisë së standardeve	Përfshirje e të gjitha palëve të interesit në standardiz im	Sensibilizim i i rolit dhe rëndësisë së standardizi mit përmes sesioneve informative dhe punëtorive ne institucione arsimore, qeveritare, biznese, industri, etj.	Dhjetë punëtor i, konfere nca ose sesione inform uese	Inkuraji mi i biznesev e, industris ë, instituci oneve dhe palëve tjera të interesit për tu përfshirë në standardi zim	Punëtori, konferenca dhe sesione informuese; katalog, buletine dhe materiale tjera promovuese të botuara	6,700. 00 €	Ligji nr. 06- L-019 për standardizim , Strategjia Afatmesme e Agjencisë Kosovare për Standardizi m 2020- 2025.
4. Menaxhimi dhe funksionalizimi i	Digjitalizi mi i standardiz	Digjitalizimi i standardizi	SMIS dhe ueb	SMIS dhe WEBe	Plotësimi me të dhëna në baza ditore	N/A	Strategjia Afatmesme e Agjencisë

databazës SMIS dhe WEB	imit dhe publikimi i çdo standardi SK	mit është i pamundur pa aplikimin e një sistemi softuerik të veçantë të standardeve. Data baza aktuale SMIS (Standard Management Information System) është funksionale, mirëpo funksionalizimi i plotë i saj kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme (update+ upgrade te sistemit).	faqe e updatuar	qasshme për të gjitha palët e interesit	dhe mirëmbajtje e SMIS dhe WEB		Kosovare për Standardizim 2020 - 2025.
5. Notifikimi i standardeve në CEN; CENELEC; DPS Dhe ASTM	Notifikimi i 550 standardeve	Notifikimi i standardeve të shitura dhe adoptuara	Përgatitja e listave me standarde të shitura dhe adoptuara	Konfirmimi nga CEN; CENELEC; DPS dhe ASTM për standarde	Identifikimi i të gjitha standardeve të shitura gjatë vitit dhe ato të adoptuara për notifikim	3,800.00 €	Ligji nr. 06-L-019 për standardizim , Marrëveshjet AKS-CEN; CENELEC; DPS; ASTM.